



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 10, datë 28.07.2016

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “RESORT TURISTIK”, ME
VENDNDODHJE NË GJIRIN E LALZIT, BASHKIA DURRËS

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr. 1097, datë 28.12.2015 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozim të shoqërisë “OMNIX Albania” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Resort turistik, me vendndodhje në Gjirin e Lalzit, Bashkia Durrës”, me subjekt zhvillues shoqërinë “OMNIX Albania” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumentet e Lejes së Ndërtimit i lëshohen subjektit zhvillues, për secilën nga fazat e zhvillimit, sipas hartës bashkëlidhur këtij vendimi, vetëm pas:
 - a) miratimit nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë dhe Këshilli Kombëtar i Restaurimeve;
 - b) miratimit të vlerësimit të ndikimit në mjedis;
 - c) miratimit të aktit për heqjen nga fondi pyjor të pasurive në pronësi të subjektit zhvillues;
 - d) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, për secilën nga fazat, për llogari të Bashkisë Durrës.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA

ZËVENDËS KRYETAR I KKT

EGLANTINA GJERMENI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN



SEKRETAR I KKT

LEDIA TOTA

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

